



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 976/3 prot

Datë 08.06.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 487/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2023 me:

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesat e paraqitura nga operatorii ekonomik “Interlogistic” SHPK, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68004-05-02-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 2,000,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68004-05-02-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 2,000,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK  
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, rruga Dytësore Km. 9,  
Godinë 3 katëshe, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a  
Adresa: Rr. “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz,

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

*miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.05.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68004-05-02-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 2,000,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

II.2. Në datën 08.05.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3079 dhe me nr. 976 prot., datë 08.05.2023 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Me shkresën nr. 806/5 prot., datë 17.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 976/2 prot., datë 19.05.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “Interlogistic” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 806/5 prot., datë 17.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 976/2 prot., datë 19.05.2023 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

*“[...]Për pretendimin II....*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se Interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, pasi mendojmë që Gërshërët duhet të jenë përmasë minimumi 14 cm. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin III....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Maja duhet të jetë 0.5- 0.6mm. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VI....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Ditari duhet të jetë format A3 dhe minimumi 100 fletë..Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VII....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Kërkojmë Libra protokollit të mëdhenj me 200 fletë. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VIII....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Blloqet duhet të jenë minimumi me 500 fletë, pa kufizuar maksimumin. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin IX....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Madhësia për këto dy artikuj duhet të jetë A4. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin X....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Ky artikull duhet të jetë me 3 kopje, pa numër serial. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XI...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Libri i magazinës duhet të jetë me 500 fletë. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XII...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Këto dy artikuj duhet të jenë format A4. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XIV...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Gjatësia 15 cm dhe gjërësia 25 cm për të dy artikujt. Kjo kërkesë pranohet. [...]*

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 806/5 prot., datë 17.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 976/2 prot., datë 19.05.2023 rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Interlogistic*” SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

***[...]Për pretendimin II...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se Interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, pasi mendojmë që Gërshërët duhet të jenë përmasë minimumi 14 cm. Kji kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin III...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Maja duhet të jetë 0.5- 0.6mm. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VI...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Ditari duhet të jetë format A3 dhe minimumi 100 fletë..Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VII...***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Kërkojmë Libra protokolli të mëdhenj me 200 fletë. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin VIII....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Blloqet duhet të jenë minimumi me 500 fletë, pa kufizuar maksimumin. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin IX....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Madhësia për këto dy artikuj duhet të jetë A4. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin X....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Ky artikull duhet të jetë me 3 kopje, pa numër serial. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XI....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Libri i magazinës duhet të jetë me 500 fletë. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XII....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Këto dy artikuj duhet të jenë format A4. Kjo kërkesë pranohet.*

***Për pretendimin XIV....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është i drejtë, Gjatësia 15 cm dhe gjërësia 25 cm për të dy artikujt. Kjo kërkesë pranohet. [...]”.*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 976 protokollit me datë 08.05.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3079 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Interlogistic” SHPK se: “Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve për artikullin nr. 3 “**Stilolaps rapidograf**” me specifikime teknike “**Stilolaps rapidograf me majë fine 0.3 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Keto specifikime të jene të shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit.**” na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të ndryshojë togfjalëshi “Keto specifikime të jene të shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit” pasi vendosja e specifikimeve teknike në trupin e produktit është politikë e prodhuesit dhe ne si tregtarë nuk mund të influenciojmë se ku do jenë të pranishme specifikimet teknike. Prandaj kërkojmë që ky specifikim teknik të ndryshojë duke i dhënë mundësi çdo ofertuesi të marrë pjesë në procedure.

Për artikullin nr. 21 “**Vizore 50cm me mbajtese**”, me specifikime teknike “**Vizore 50cm me mbajtese**” kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të hiqet termi mbajtëse, pasi nuk ndikon në funksionalitetin e produktit.

Përsa i përket specifikimeve teknike të artikullit **letër format A4 80 gr/m2** të kërkuara nga ana e juaj, janë kufizuese konkretisht specifikimi, **Shkelqimi  $\geq 112$  %**.

Përcaktimi i mësipërm i AK është kufizues, diskriminues dhe nuk garanton të drejtën e OE të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Këto specifikime në lidhje me artikullin e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin është vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standartin e lartë për këtë produkt. Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime të letrës me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë **me minimum dhe maksimum** duke krijuar mundësinë e ofertimit të letrave të ndryshme por

**gjithmonë cilësore** nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër kërkojmë nga ana e AK që specifikimi i ankimuar më lart të bëhet **Shkelqimi 100-115 %**.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga **vendimi i KPP-së Nr. 249/2020, Vendimi 355/2020, vendimi 1209/2022 si dhe vendimi nr. 200/2022 datë 25.02.2022**.

Nga sa më sipër kërkojmë që të informoheni mbi llojet e letrës që ekzistojnë dhe të bëni përcaktimet e sakta për artikullin letër që ju kërkoni. Gjithashtu në lidhje me artikullin "Leter A4" duhet të mbani parasysh që Autoretitet Kontraktore kur hartojnë / publikojnë një procedurë prokurimi, duhet të mbajnë në vëmendje përcaktimet ligjore në lidhje me kriteret e vendosjes së parametrave për artikujt që prokurojnë. Këto parametra të vendosura për artikujt e mësipërm janë parametra të cilat nuk garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomike të interesuar në këtë procedurë prokurimi dhe nuk lidhen me garantimin e cilesise se produktit, pasi ky produkt mund të ofrohet me të njëjtin standart cilësie dhe duke pasur një marzh më gjërë **parametrash në minimum**".

Për artikullin **nr. 49 "Dosje me buton"** me specifikime teknike **"Dosje me buton 16 cm, me doreze. Materiali plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires"**, kërkojmë të vendoset marzh përse i përket përmasave. Dosjet standarte që janë në treg janë 15 cm. Gjithashtu kërkojmë hiqet termi plastik.

Kurse për artikullin **nr. 64 "Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza"** me specifikime teknike **"Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne pjesen e jashteme te kete minimumi dy xhepa te medhenj ~ A4. Ne pjesen e brendshme te jete e pajisur me bllok A4, vend per mbajtese stilolapsi, nje xhep per format A4 dhe disa xhepa te vegjel per kartvizita"**, konkludojmë që specifikimet teknike të artikullit të vendosura nga ana e AK të drejtojnë drejt një marke/artikulli të caktuar. Përse më sipër kërkojmë që të rishikohen specifikimet në mënyrë që të mund të ofertohej lloje të ndryshme dosjesh me unaza. Gjithashtu kërkojmë që të hiqet elementi "doreza" pasi nuk ndikon në funksionalitetin e produktit, si dhe të hiqen xhepat e jashtem, si dhe të vendoset min max unazash 2-4 unaza.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**"Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një

*Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkangjitur ne SPE*

*Specifikimi i Materialeve: Bashkangjitur ne SPE*

*Specifikimi I tonerave:*

***-Tonerat duhet te jene origjinale ose ekuivalent, te mos jene te rimbushura (Recondition); te mos jene te ricikluara (Remanufactured); te mos jene te riprodhuara; te jene te paketuara e te pahapura.***

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkangjitur ne SPE".*

III.2.2. Në dokumentin e ngarkuar në sistem me emërtim “Lista e Mallrave të kërkuara dhe Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi për zërat me nr rendor. 3, nr. 21, nr. 25, nr. 49 dhe nr. 64, përcaktohet si më poshtë:

“[...]

NR	Emërtimi	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia
3	Stilolaps rapidograf	Stilolaps rapidograf me majë fine 0.3 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit.	Copë	1,000
21	Vizore 50cm me mbajtese	Vizore 50cm me mbajtese	Copë	10
25	Leter A4 80gr/m2	Leter A4 80gr/m <sup>2</sup> . Bardhesi CIE $\geq 160$ Trashesi $\mu\text{m} \geq 110$ . Lemueshmeri ml/min $\leq 120$ Lageshti % $\leq 4$ Shkelqimi % $\geq 112$ Drite % $\geq 95$ Ashpersia (aftesia) ne perkulje MD, mN $>95$ Ashpersia (aftesia) ne perkulje CD, MN $>30$	Rizma/50 ofl	700
49	Dosje me buton	Dosje me buton 16 cm , me doreze. Materiali plastik ose	Copë	100



		ekuivalent, rezistent ndaj lageshtires.		
64	Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza.	Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza. Ne pjesen e jashteme te kete minimumi dy xhepa te medhenj ~ A4. Ne pjesen e brendshme te jete e pajisur me bllok A4, vend per mbajtese stilolapsi, nje xhep per format A4 dhe disa xhepa te vegjel per kartvizita.	Copë	600

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.2.6. Nga shqyrtimi i “Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, të publikuar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me specifikimet e mësipërme, ky i fundit argumentuar:

- **“SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, është bërë nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Fondi Limit i kësaj procedure është bazuar në testimine e tregut dhe kontratat e mëparshme.*

*Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punës duke ju referuar qellimit për të cilin do të përdoren artikujt.*

*Specifikimet e tonerave janë vendosur duke pasur në konsideratë tipet e pajisjeve multifunksionave që institucioni yne ka në përdorim.”.*

III.2.7. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit nuk i ka pranuar këto pretendime me arsyetimin si vijon:

*“1.1 Referuar kriterit të vendosur nga njësia e prokurimit, Komisioni i Shqyrtimit të ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri është nuk është i drejtë, pasi Njësia prokurimit është shprehur që specifikimet teknike të jenë të shkruara në trup, ose në katalogun e prodhuesit, pra nëse nuk janë të shkruara në trup të produktit, të paraqitet katalogu i prodhuesit ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike, që ne si AK të kemi mundësinë që të vërtetojmë që këto specifikime plotësohen. Në rast se do të paraqitet katalog, duhet të hidhet si dokument në SPE. Rrjedhimisht kjo kërkesë nuk pranohet.*

***Për pretendimin IV.....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri nuk është i drejtë. Sqarojmë se, meqënëse vizorja është e gjatë, mbajtësja krijon lehtësi në përdorimin e saj. Kjo kërkesë nuk pranohet.*

***Për pretendimin V....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri nuk është i drejtë. Së pari, shkëlqimi nuk është kërkuar =112% sic ju po pretendoni, por  $\geq 112\%$ . Pra nuk është kërkuar një parametër fiks dhe as një diapazon i kufizuar siç e kërkonti ju, por është përcaktuar minimumi i tij 112% dhe maksimumi është lënë i hapur, pikërisht për të krijuar një diapazon të gjerë.*

*Ky është një parametër cilësie, që ka të bëjë me standartin që kërkojmë për paraqitjen e letrës.*

*Shkëlqimi siguron që gërmat të kenë kontrastin e duhur në fletë. Shkëlqimi në nivelin duke filluar nga 100%, nuk është në raport të drejtë me specifikimet e tjera dhe nuk siguron një letër cilësore.*

*KSHA gjykon se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mallra me cilësi të cilat do të përmbushin nevojat e tij, kjo për sa kohë nuk kufizohet konkurrenca. Gjithashtu hartimi i këtyre specifikimeve është bërë në mënyrë të tillë që nga përdorimi i mallit objekt prokurimi mos të kenë probleme teknike dhe funksionale. KSHA gjykon se këto kërkesa janë në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurrohet dhe jodiskriminuese, duke krijuar kushte për një konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve dhe ofertuesëve. OE nuk ka arritur të provojë që ky parametër kufizon konkurrencën. Rrjedhimisht kjo kërkesë nuk pranohet.*

### ***Për pretendimin XIII....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri nuk është i drejtë, pasi ju ngrini një ankesë apriori, pa u bazuar në fakte konkrete.*

*Nuk keni dhënë asnjë provë në mbështetje të ankesës tuaj, pasi për këto dosje nuk a një standart të caktuar. Cili është standarti ku ju bazoheni, përse nuk e keni shprehur këtë standart në ankesën tuaj?!*

*Në treg gjenden rëndom dosje me buton të përmasav të ndryshme, ku ndër to përfshihen edhe përmasa 16cm. Këtë gjë e kemi konstatuar edhe gjatë procesit të testimit të tregut.*

*Megjithatë, për të krijuar një marzh më të gjerë, përmasa e dosjes do të bëhet 16cm ±2%.*

*Sa i takon termi “plastik” jemi shprehur që “materiali të jetë plastik ose ekuivalent, rezistent ndaj lagështirës”. Pra kemi pranuar ekuivalencën, por gjithmonë duke përmbushur specifikimet teknike. Kjo kërkesë pranohet pjesërisht.*

### ***Për pretendimin XV....***

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se interpretimi që i bën operatori ekonomik këtij kriteri nuk është i drejtë, Së pari, pretendimi juaj që “specifikimet teknike drejtojnë drejt një marke/artikulli të caktuar” është i pabazuar në fakte dhe prova. Nuk keni paraqitur asnjë provë të vetme në mbështetje të pretendimit tuaj.*

*Siç e dikton LPP, para publikimit të procedurës, autoriteti ynë ka bërë testimin e tregut për llogaritjen e fondit limit dhe ka marrë oferta nga 3 operatorë të ndryshëm, gjë që tregon se ky produkt gjendet lehtësisht në tregun vendas.*

*Kërkesa juaj që të hiqet elementi “dorezë” dhe “xhepat e jashtëm”, do ta ndryshonte rrënjësisht produktin që nevojitet për institucionin tonë. Heqja e këtyre specifikimeve, të con drejt një produkti komplet tjetër, duke mos përmbushur nevojat tona. Si “doreza” ashtu edhe “xhepat e jashtëm” ndikojnë drejtpërdrejtë në funksionalitetin e produktit. Doreza nevojitet për të mbajtur dosjen gjatë punës në terren, ndërsa xhepat nevojitet për të mbajtur dokumentat dhe materialet e ndryshme të punës.*

*Sa i takon unazave, numri i unazave ka të bëjë me qëndrimin sa më drejt të dokumentave brenda dosjes, duke shmangur dëmtimin e tyre. Kjo kërkesë nuk pranohet.”.*

III.2.7.a. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit lidhur me heqjen e specifikimit teknik sa i përket togëfjalëshit “*Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne katalogun e prodhuesit*” që kërkohet në zërin 3 “*Stilolaps rapidograf*” në dokumentin e ngarkuar në sistem me emërtim “*Lista e Mallrave të kërkuara dhe Specifikimet teknike*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht, se si ky specifikim ndikon në realizimin me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar.

Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit lidhur me heqjen e këtij specifikimi, si dhe kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, ky i fundit nuk e ka pranuar këtë pretendim. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë specifikim teknik në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.7.b. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK sa i përket specifikimeve teknike me numër rendor. 21, 49 dhe nr. 64. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentesh me qëllim përfitimin e një malli apo shërbimi me performancë të lartë e me çmim të ulët. Referuar rastit konkret KPP vëren, se bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, si dhe argumentimet e këtij të fundit në lidhje me pretendimet e tij, ai nuk ka arritur të argumentojë teknikisht se si për produktin me numër rendor 21 ndikon heqja e termit “mbajtëse” në funksionalitetin e produktit dhe në sigurimin e një procesi pune më efektiv dhe eficient për këtë pajisje, në artikullin me numër rendor 49 për sa i përket termit “plastike” gjithashtu nuk ka arritur të argumentojë se ku ndikon në funksionalitetin e produktit, për më tepër që autoriteti kontraktor ka parashikuar që dosjet të jenë plastike ose ekuivalent, sa i përket përmasës së dosjes autoriteti kontraktor e ka pranuar duke e modifikuar atë në  $16 \pm 2\%$ , si dhe për artikullin me nr. 64 në “Dosje me kater unaza me zinxhir, imitim lekure, me doreza” operatori ekonomik nuk ka arritur të argumentojë se si ndikojnë ndryshimet e kërkuara në funksionalitetin e produktit të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik e gjykon të drejtë vendosjen e specifikimeve të tilla, pasi autoriteti kontraktor në kthim përgjigjen e tij ka arritur të argumentojë teknikisht se si ndikojnë këto specifikime në produktet e kërkuara.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk qëndrojnë.

III.2.7.c. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Interlogistic” SHPK ku kërkon që për produktin me nr. rendor 25 “Leter A4 80gr/m2”, ku kërkon të përcaktohet një diapason sa i takon shkëlqimit të letrës.

III.2.7.c/1. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me

projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin public” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”*. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjitha kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”**

III.2.7.c/2. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se

autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimale dhe me diapazon të gjerë duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave, në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të provohet se mallrat objekt-prokurimi, përmbushin kushtet funksionale.

III.2.7.c/3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit ku kërkon që për produktin me nr. rendor 25 “Leter A4 80gr/m<sup>2</sup>” ku kërkon të përcaktohet një diapazon sa i takon shkëlqimit të letrës. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe ka detyrë të mirëargumentojë vendosjen e parametrave për produktet e kërkuara në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një numër të kufizuar produktesh, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik. Autoriteti Kontrktor duhet të evitojë përcaktime fikse apo vlera të larta, në rastin konkret të përcaktimit të shkëlqimit të letrës, në mënyrë që të mos ketë asnjë element që çon në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me shkëlqimin e letrës, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një diapazon minimum dhe maksimum, pra të rishikojë parametrat e shkëlqimit duke vendosur një diapazon + - për produktin për sa kohë që nuk çënojnë mirëfunksionimin e tij.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68004-05-02-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 2,000,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a.



2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68004-05-02-2023, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 2,000,000 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**KreshnikTernova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

